



# TaxNews

*SPECIAL*

Janar 2020  
January 2020



**Deloitte.**

- 
- **Paketa Fiskale 2020**  
Ligji “Për tatimin mbi të ardhurat”
  - **Fiscal Package 2020**  
Law “On income tax”

Në Fletoren Zyrtare nr. 184, datë 31.12.2019 është publikuar Ligji nr. 84/2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, 'Për tatimin mbi të ardhurat', të ndryshuar", pjesë e Paketës Fiskale 2020. Më poshtë kemi paraqitur vetëm ato ndryshime të këtij ligji që hyjnë në fuqi më 15.01.2020, të cilat nuk kanë për qëllim përputhshmërinë me ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

In the Official Gazette no. 184, dated 31.12.2019 has been published the Law no. 84/2019, "On some additions and amendments to the Law no. 8438, dated 28.12.1998 'On income tax', as amended", part of Fiscal Package 2020. Below we have presented only those amendments of this law that shall enter into force on 15.01.2020, which are not intended for compliance with law on invoices and the turnover monitoring system.

## ● Incentiva dhe lehtësi tatimore

### **Tatim mbi fitimin në masën 5% për industrinë automotive**

Industria automotive parashikohet të incentivohet përmes uljes së shkallës së tatimit mbi fitimin nga 15% në 5%. Një vendim i Këshillit të Ministrave pritet të përcaktojë aktivitetet, procedurat dhe kriteret për të përfituar nga zbatimi i normës së reduktuar prej 5%.

### **Rregull i ri për mbartjen e humbjeve fiskale**

Për tatimpaguesit që investojnë në projekte biznesi me vlerë mbi 1 miliard lekë parashikohet zgjatje e periudhës së mbartjes së humbjeve tatimore nga 3 në 5 vjet, duke ndjekur parimin e mbulimit të humbjeve më të hershme më përpara. Një udhëzim i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë pritet të përcaktojë kriteret dhe procedurat për zbatimin e këtij rregulli.

### **Sponsorizimet sportive**

Një tjetër incentivë parashikohet për shoqëritë që realizojnë fitim të tatueshëm mbi 100 milionë lekë në rastin kur sponsorizojnë veprimtari të ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislativi i fushës. Aktualisht, këto lloj sponsorizimesh njihen si shpenzime të zbritshme deri në masën prej 3% të fitimit para tatimit.

## ● Tax incentives and reliefs

### **5% corporate income tax for the automotive industry**

The automotive industry is expected to be stimulated by decreasing corporate income tax rate from 15% to 5%. A decision of the Council of Ministers is expected to set out the activities, procedures and criteria to benefit from the implementation of the 5% reduced rate.

### **New rule for carrying forward of fiscal losses**

For taxpayers investing in business projects worth more than ALL 1 billion, the tax loss carry forward period is extended from 3 to 5 years, on basis of the principle that earlier losses are covered first. An instruction of the Minister of Finance and Economy is expected to set out the criteria and procedures for applying this rule.

### **Sportive sponsorships**

Another incentive is provided for companies with a taxable profit more than ALL 100 million for sponsorships of sports teams activities, part of sports federations recognized by the relevant legislation. Currently, these types of sponsorships are recognized as deductible expenses up to 3% of pre-tax profit.

Tashmë, për llogaritjen e tatimit mbi fitimin, këto lloj shoqërisë do të mund të konsiderojnë si të zbritshëm trefishin e vlerës së sponsorizimeve të kryera e të njohura brenda kufirit të mësipërm. Nëse mbetet ndonjë pjesë e pazbritur, ajo nuk do të lejohet të mbartet e të zbritet në periudhat pasardhëse.

Për të përfituar nga kjo lehtësi, këto shoqëri duhet të ndjekin procedura të posaçme për të marrë "autorizimin e sponsorizimit" të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, procedura këto që pritet të përcaktohen nga një udhëzim i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

### **Shpenzimet e përfaqësimit për eksportuesit**

Për eksportuesit të cilët kanë realizuar në 3 vitet e fundit më shumë se 70% të të ardhurave nga eksporti (me përjashtim të prodhuesve me materiale të porositësve), masa e njohjes si të zbritshme të shpenzimeve të përfaqësimit jashtë vendit (për pjesëmarrje, prezantim në panairë apo ekspozita ndërkombëtare) rritet nga 0.3% në 3% të qarkullimit vjetor.

Following this amendment, for the purpose of calculating the corporate income tax, qualifying companies may consider as deductible the triple of the value of sponsorships, recognized within the above limit. If any part thereof remains non-deductible, it will not be allowed to be carried over and deducted in the next periods.

In order to benefit from this incentive, qualifying companies must follow special procedures to obtain the "sponsorship authorization" from the General Tax Director, which are expected to be set out by an instruction of the Minister of Finance and Economy.

### **Representative expenses for exporters**

Exporters who have realized more than 70% of their revenue from exports in the last 3 years (excluding manufacturers working under inward processing models), the extent of recognition as deductible expenses of representation costs abroad (for participation and presentation in international fairs or exhibitions) increases from 0.3% to 3% of the annual turnover.

## ● **Ndryshimi i pronësisë**

Paketa Fiskale 2019 solli disa rregulla të reja lidhur me pagesën e tatimit mbi "fitimin e konsideruar" nga personi juridik subjekt i ndryshimit të pronësisë direkte ose indirekte të kapitalit të tij apo të të drejtave të votës.

Këto rregulla ngarkojnë me detyrim tatimor personin juridik subjekt të ndryshimit të pronësisë, kur përmbushen kushte të caktuara, edhe pse ky person nuk është pjesëmarrës në transaksionin e shitblerjes dhe nuk realizon asnjë fitim kapital nga ky transaksion.

## ● **Change of ownership**

The Fiscal Package 2019 introduced new rules around the payment of tax on "deemed profits" by a legal entity subject of a direct or indirect change of ownership of its capital or voting rights.

These rules charge a tax liability to the legal entity subject to the change of ownership when certain conditions are met, even though that person is not a participant in the transaction and does not realize any capital gain from this transaction.

Këto rregulla parashikojnë edhe detyrimin për njoftim ndaj autoriteteve tatimore nga personi juridik subjekt i ndryshimit të pronësisë si dhe dënimet për mosnjoftim.

Paketa Fiskale 2020 sjell një saktësim në lidhje me këtë dispozitë. Konkretisht, parashikohet që këto rregulla nuk do të zbatohen në rastet kur ndryshimi i pronësisë i nënshtrohet dispozitave të marrëveshjeve të ratifikuara për shmangien e tatimit të dyfishtë në fuqi.

#### ● **Tatimi i të ardhurave nga paga prej më shumë se një burim**

Të gjithë individët që janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës do të kenë detyrimin të dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave, pavarësisht se shuma e përgjithshme e të ardhurave të realizuara gjatë vitit prej tyre nuk do të tejkalojë 2 milionë lekë.

Në deklaratën vjetore, këta individë do të deklarojnë në një shumë të vetme përkatësisht (1) totalin vjetor të të ardhurave të siguruara nga punësimi, (2) totalin vjetor të detyrimit të tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi të vetëllogaritur prej tyre për çdo muaj të vitit, si dhe (3) totalin vjetor të tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi të mbajtur në burim nga punëdhënësit për çdo muaj të vitit. Sipas rastit, këta individë do duhet të paguajnë diferencën mes shumave (2) e (3) më lart.

These rules provide the obligation to notify the tax authorities for the legal entity subject of the change in ownership, as well as penalties for failure to notify.

The Fiscal Package 2020 introduced a clarification around this provision. Specifically, it provides that these rules shall not apply where the change of ownership is subject to the provisions of ratified agreements in force for the avoidance of double taxation.

#### ● **Tax on salary earnings from more than one source**

All individuals employed by more than one employer will be required to file an annual income declaration, regardless that the total amount of their earnings during the year will not exceed ALL 2 million.

In the annual declaration, these individuals shall declare in a single amount respectively (1) the total annual income received from employment, (2) the total annual personal income tax liability calculated by them each month of the year, as well as (3) the total annual personal income tax withheld by the employer for each month of the year. Where appropriate, these individuals will have to pay the difference between amounts (2) and (3) above.

- **Dhurimi i pronave/ndarja e pasurisë brenda familjes**

Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi banesën dhe/ose truallin nëpërmjet dhurimit ose heqjes dorë nga pasuria do të jetë i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale, kur ky kalim ndodh brenda lidhjes gjinore në familje (pra, ndaj dhe midis bashkëshortit/es e fëmijëve) dhe vetëm një herë ndaj një përfituesi.

- **Donating properties/ownership split between family members**

The transfer of ownership rights over a building and/or land through donation or waiving of the property rights will be exempt from personal income tax, when such transfer occurs between family members (thus, between the spouses and children) and only once towards a beneficiary.

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services  
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Faik Konica", Ndërtesa nr.6  
Hyrja nr.7, 1010  
Tirana | Albania  
Mob: +355 68 60 33 116  
E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 290,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.